

LIGJ
Nr.9611, datë 18.9.2006

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN E KONTROLLIT TË GRIPIT TË SHPENDËVE DHE PËRGATITJES PËR PARANDALIMIN E PANDEMISË HUMANE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e kontrollit të gripit të shpendëve dhe përgatitjes për parandalimin e pandemisë humane”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5036, datë 26.9.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE FINANCIMI
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

Marrëveshje e datës _____ 2006, ndërmjet Shqipërisë (“Përfituesit”) dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (“Shoqata”). Përfituesi dhe Shoqata bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushte të përgjithshme; përkufizime

1.01. Kushtet e përgjithshme (siç parashikohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02. Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në Marrëveshjen e Financimit kanë kuptimin që u jepet në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Financimi

2.01. Shoqata bie dakord që t’i japë Përfituesit, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara apo referuara në këtë Marrëveshjeje, një kredi në shumën ekuivalente të tre milionë dhe pesëqindmijë Të Drejta Speciale të Tërheqjes (SDR 3 500 000) (“Kredi”) për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në Planin 1 të kësaj Marrëveshjeje (“Projekti”).

2.02. Përfituesi mund ta tërheqë shumën e financimit në pajtim me seksionin V të Planit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03. Tarifa maksimale e përkushtimit që paguhet nga Përfituesi mbi Balancën e Patërhequr të Financimit do të jetë 1/2 e 1% në vit.

2.04. Tarifa e Shërbimit që paguhet nga Përfituesi mbi Balancën e Tërhequr të Kredisë do të jetë

tre të katërtat e një për qind (3/4 e 1 %) në vit.

2.05. Datat e pagesave janë 1 maji dhe 1 nëntori i çdo viti.

2.06. Shuma principale e Kredisë do të ripaguhet sipas kalendarit të ripagimeve të parashikuar në Planin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07. Monedha e pagesës është dollari.

Neni 3

Projekti

3.01. Përfituesi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit, që është pjesë e Programit Global të Shoqatës për Kontrollin e Influcencës Aviare dhe Përgatitjen për dhe Trajtimin e Pandemisë Njerëzore, hartuar për të ndihmuar vendet në parandalimin, kufizimin, kontrollin dhe zhdukjen e influencës aviare. Për këtë qëllim, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit do të zbatotojë Projektin në përputhje me dispozitat e nenit 4 të kushteve të përgjithshme.

3.02. Duke mos u kufizuar në dispozitat e paragrafit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe me përjashtim të rasteve kur Përfituesi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, Përfituesi garanton që Projekti do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Planit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Mjetet e mbrojtjes për Shoqatën

4.01. Ngjarja Shtesë e Pezullimit konsiston sa më poshtë, kryesisht kur:

i) Në pajtim me nënparagrafin (ii) të këtij paragrafi, e drejta e Përfituesit për të tërhequr shumën e Grantit të Bashkëfinancimit është pezulluar, anuluar apo shfuqizuar plotësisht apo pjesërisht, sipas kushteve të Marrëveshjes për Grantin e Bashkëfinancimit.

ii) Nënparagrafi (i) këtij paragrafi nuk zbatohet nëse Përfituesi e bind Shoqatën që: (A) kjo ndërprerje, anulim apo shfuqizim nuk është shkaktuar nga mospërmbushja nga Përfituesi i detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Grantit të Bashkëfinancimit; dhe (B) Përfituesi ka fonde të mjaftueshme për Projektin nga veprime të tjera, sipas afateve dhe kushteve të detyrimeve që përputhen me detyrimet e Përfituesit në bazë të Marrëveshjes së Grantit të Bashkëfinancimit.

Neni 5

Hyrja në fuqi; shfuqizimi

5.01. Kushtet shtesë që kanë të bëjnë me hyrjen në fuqi të kontratës do të jenë si më poshtë:

a) Programi Vjetor i Punës për vitin e parë të zbatimit të Projektit është përgatitur dhe miratuar nga Përfituesi me pëlqimin e Shoqatës;

b) Manuali Operacional i Projektit miratohet nga Përfituesi me pëlqimin e Shoqatës;

c) Plani i Menaxhimit të Mjedisit miratohet nga Përfituesi me pëlqimin e Shoqatës;

d) Marrëveshja bashkëfinancuese e grantit është ekzekutuar dhe dorëzuar dhe janë përmbushur të gjitha kushtet për hyrjen në fuqi të saj dhe për të drejtën e Përfituesit për të bërë tërheqje në kuadër të saj (përveç kur Marrëveshja hyn në fuqi).

5.02. Afati përfundimtar i hyrjes në fuqi është dita e nëntëdhjetë (90) pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Përfaqësuesi; adresa

6.01. Përfaqësuesi i Përfituesit është Ministria e Financave.

6.02. Adresa e përfituesit është:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë, Shqipëri

Faksimile:

+3554228494

6.03. Adresa e Shoqatës është:
International Development Association (Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar)
181.8 H Street, NW.
Washington, D.C. 20433
Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kabëll: Teleks Faksimile
INDEVAS 248423 (MCI) or 1-202-477-6391
Washington, D.C. 64145 (MCI)

Ranë dakord në _____ që nga data dhe viti i shkruar në fillim të dokumentit.

KAPITULLI 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivat e projektit kanë të bëjnë me fuqizimin e kapaciteteve të vendit për të: (i) parandaluar përhapjen e një Influence Aviare Patogjene të Lartë (IAPL) tek shpendët; (ii) parandaluar transmetimin e IAPL nga zogjtë tek kafshët e tjera dhe njerëzit; dhe (iii) përgatitjen për një pandemi të mundshme të IAPL e transmetueshme ndërmjet qenieve njerëzore.

Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme të cilat mund të modifikohen pasi Përfituesi dhe Shoqata mund të bien dakord kohë pas kohe në funksion të përmbushjes së objektivave:

PJESA I NDËRGJEGJËSIMI I PUBLIKUT DHE FUSHATA INFORMUESE

Ofrimi i asistencës teknike, trajnimeve dhe mallrave për Taskën Forcën e Influençës Aviare që të: (a) kryejë një fushatë informimi me synim informimin e publikut të gjerë mbi statusin e IAPL dhe rrugëve për të minimizuar rrezikun e transmetimit dhe përhapjes së IAPL, dhe kryejë aktivitetet adekuate për një koordinim dhe bashkëpunim efektiv ndërmjet aktorëve dhe (b) zhvillojë e zbatojë një plan për informimin dhe komunikimin me publikun.

PJESA II SHËNDETI I KAFSHËVE

1. Ofrimi i asistencës teknike dhe mallrave për të: (a) hartuar një legjislacion të aplikueshëm, rregulla dhe protokolle në fushën e shërbimeve dhe inspektoratit veterinar; (b) përmirësuar planin kombëtar të Përfituesit për influencën pandemike; dhe (c) mbështetur në planifikimin dhe zbatimin e një studimi pilot me synim përmirësimin e menaxhimit në sektorin e shpendarisë.

2. Ofrimi i asistencës teknike, trajnimeve, mallrave dhe punëve për të: (a) fuqizuar survejimin epidemiologjik veterinar nëpërmjet krijimit të Njesisë Kombëtare Veterinare të Epidemiologjisë (NJKVE) brenda Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; (b) forcuar kapacitetet diagnostikuese dhe përmirësuar nivelet e bio-sigurisë brenda Institutit të Kërkimeve Veterinare, dhe (c) përmirësuar sistemet e informimit për sëmundjet tek kafshët.

3. Ofrimin e asistencës teknike, trajnimeve, mallrave dhe shërbimeve për të mbështetur aktivitetet e parashikuara në kuadrin e programeve për kontrollin e IAPL dhe programet e kontrollit të epidemive, përfshirë: (a) grumbullimin e shpendëve të infektuar dhe atyre në rrezik; (b) groposjen e shpendëve të ngordhur dhe materialeve potencialisht infektuese në një mënyrë bio-të sigurt dhe të pranueshme për mjedisin; (c) garantimi i bio-sigurisë dhe veshjeve mbrojtëse të përshtatshme për personelin veterinar dhe punonjësit e laboratorit; dhe (d) krijimin dhe vënien në efikasitet të një Fondi Kompensimi për kompensimin e pronarëve të shpendëve që grumbullohen për asgjësim me urdhër të Qeverisë.

PJESA III SHËNDETI NJERËZOR

1. Ofrimi i asistencës teknike për përmirësimin e planifikimit dhe koordinimit të programeve për shëndetin publik nëpërmjet: (a) fuqizimit të mekanizmave komandues dhe koordinues brenda sektorit të shëndetësisë; (b) rishikimit të planit të Ministrisë së Shëndetësisë për emergjencat; (c) përgatitjes së një plani të detajuar për përcaktimin e prioritetëve operacionale dhe identifikimin e roleve dhe përgjegjësi

për çdo nivel të sistemit shëndetësor; dhe (d) hartimit të një plani të zbatueshëm në lidhje me masat për “distancimin social” dhe “dezinfektimin spitalor” në rastin e një epidemie.

2. Ofrimi i asistencës teknike, trajnimeve dhe mallrave për (a) forcimin e sistemit kombëtar tëurvejimit publik në Laboratorin Kombëtar të Influcencës; dhe (b) mbështetjen e kapaciteteve të ISHP dhe ekipeve rajonale të investigimit dhe veprimit epidemio1logjik.

3. Ofrimi i asistencës teknike, trajnimeve, mallrave dhe shërbimeve për të fuqizuar kapacitetet reaguese të sistemit shëndetësor nëpërmjet: (a) blerjes dhe ofrimit të vaksinave kundër influcencës sezonale dhe asaj aviare; (b) blerjes së anti-viraleve dhe hartimit të udhëzimeve për përdorimin e tyre; dhe (c) fuqizimit të kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve mjekësore për izolimin dhe trajtimin e pacientëve me sëmundje të transmetueshme serioze.

PJESA 4

MBËSHËTETJE TASK FORCËS SË INFLUCENCËS AVIARE NË ZBATIMIN E PROJEKTIT

1. Ofrimi i asistencës teknike, mallrave dhe trajnimeve për të mbajtur një Sekretariat të Përhershëm brenda Task Forcës së Influcencës Aviare me një staf me kohë të plotë pune përgjegjës për menaxhimin e Projektit.

2. Ofrimi asistencës teknike për të mbështetur kapacitetet monitoruese dhe vlerësuese së projektit, përfshirë hartimin e një planiveprimi për monitorimin dhe vlerësimin e projektit.

KAPITULLI 2 ZBATIMI I PROJEKTIT

NËNKAPITULL I Rregullime institucionale

1. Task Forcë për Influcencën Aviare (TFIA) do të jetë përgjegjëse për të gjithë zbatimin, monitorimin dhe koordinimin ndërmjet agjencive. Ajo do të ketë një sekretariat të përhershëm, me seli në MBUMK, i kryesuar nga dy Koordinatorë të Projektit. Koordinatorët e Projektit do të punojnë me kohë të plotë në ngarkim të zbatimit të, dhe koordinimit respektivisht për pjesët I, II dhe III të Projektit. Në veçanti, Koordinatorët e Projektit do të jenë përgjegjës për: (i) menaxhimin e implementimit të aktiviteteve të MBUMK dhe MSH në kuadër të Projektit, dhe ndërmjetësimin me agjencitë përgjegjëse në nivele rajonale, bashkiake dhe komune; (ii) koordinimin me Ministrinë përkatëse për të siguruar drejtimin dhe monitoruar implementimin e Projektit në nivel qendror; dhe (iii) përgatitjen e programeve vjetore të punës, buxheteve dhe raporteve.

2. Përfituesi, nëpërmjet MBUMK dhe MSH do ta mbajë TFIA, përfshirë Sekretariatin e përhershëm të TFIA dhe Koordinatorët e Projektit, përgjatë zbatimit të Projektit sipas termave të referencës të pranuar nga Shoqata dhe me burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore, financiare dhe teknike.

3. MBUMK do të jetë përgjegjëse për prokurimin dhe aktivitetin që ka të bëjë me menaxhimin financiar të parashikuar nga Projekti. Përfituesi do të sigurojë që prokurimi dhe aktiviteti menaxhues financiar në kuadër të Projektit do të kryhet nga MBUMK sipas termave të referencës të pranuar nga Shoqata dhe me burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore, financiare dhe teknike.

NËNKAPITULL II Rregullat e zbatimit

1. Përfituesi do të përmbushë detyrimet në përputhje me Manualin e Funksionimit të Projektit dhe Planin e Menaxhimit Mjedisor, dhe nuk do të amendojë, pezullojë, abrogojë, anulojë apo anashkalojë ndonjë dispozitë të Manualit të Funksionimit të Projektit ose Planit të Menaxhimit Mjedisor pa aprovim paraprak të Shoqatës.

2. Përfituesi, nëpërmjet MSH dhe MBUMK, do t'i dorëzojë Shoqatës jo më vonë se 30 qershori i çdo viti, gjatë gjithë zbatimit të projektit, duke filluar që nga 30 qershor, 2007, një Plan Vjetor të Punës për vitin pasardhës kalendarik dhe do të bjerë dakord me Shoqatën mbi hapat që duhen ndërmarrë në vitin pasardhës kalendarik.

NËNKAPITULL III

Monitorimi i projektit, raportimi dhe vlerësimi

A. Raportet e projektit.

1. Përfituesi, nëpërmjet MBUMK dhe MSH, do të monitorojë dhe vlerësojë progresin e Projektit dhe përgatisë raportet e projektit në përputhje me dispozitat e paragrafit 4.08 mbi kushtet e përgjithshme dhe në bazë të treguesve të rënë dakord me Shoqatën. Çdo raport i Projektit do të mbulojë periudhën e një semestri kalendarik dhe do t'i dërgohet Shoqatës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga çdo raport.

2. Pa asnjë kufizim të dispozitave në paragrafin 1 të këtij nënkapitulli, Përfituesi do të:

a) përgatisë sipas termave të referencës të pranuar nga Shoqata dhe do t'i dorëzojë Shoqatës në apo rreth datës 31 dhjetor 2007, një raport me rezultatet e aktiviteteve monitoruese dhe vlerësuese të kryera sipas paragrafit 1 më sipër, mbi progresin e arritur në implementimin e Projektit gjatë periudhës që paraprin datën e raportit në fjalë, dhe duke përcaktuar masat e rekomanduara për të siguruar një zbatim eficient të Projektit dhe arritjen e objektivave gjatë periudhës në vijim të kësaj date;

b) rishikojë me Shoqatën, deri në 30 janar 2008, ose në një datë të mëvonshme, nëse këtë e vendos Shoqata, raportin e referuar në paragrafin (a) të këtij kapitulli, dhe, më pas të marrë të gjitha masat për të garantuar përfundimin eficient të Projektit dhe arritjen e objektivave që rrjedhin prej tij, bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit në fjalë dhe pikëpamjeve të Shoqatës mbi çështjen; dhe

c) përgatisë dhe dorëzojë pranë Shoqatës një program veprimesh, i pranueshëm për Shoqatën, mbi implementimin e mëtejshëm të Projektit duke u bazuar në gjetjen e raportit të referuar në paragrafin (a) dhe, më pas ta implementojë këtë program veprimesh.

B. Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe auditet.

1. Përfituesi do të mbajë ose do të bëjë të mundur mbajtjen e një sistemi të menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e nënkapitullit 4.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Pa asnjë kufizim të dispozitave të pjesës A të këtij nënkapitulli, Përfituesi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Shoqatës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, raporte të paaudituar financiare të Projektit, të cilat mbulojnë periudhën tremujore, në një formë dhe përmbajtje të pëlqyeshme për Shoqatën.

3. Përfituesi do t'i auditojë pasqyrat financiare në përputhje me dispozitat e nënkapitullit 4.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Çdo auditim i pasqyrave financiare do të mbulojë periudhën e një viti fiskal të Përfituesit. Pasqyrat e audituara financiare për secilën periudhë do t'i dorëzohen Shoqatës jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo periudhe raportimi.

NËNKAPITULLI IV

Prokurimi

A. Të përgjithshme.

1. Mallrat dhe shërbimet. Të gjitha mallrat e kërkuara për Projektin dhe që do të financohen përtej shumave të Kredisë, do të prokurohen në përputhje me kriteret e parashikuara ose të cituara në nënkapitullin I të Procedurave të Prokurimit, dhe me dispozitat e këtij kapitulli.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve që nevojiten për Projektin dhe për t'u financuar përtej shumës së Kredisë do të prokurohen në përputhje me kriteret e parashikuara ose të cituara në nënkapitullin I dhe IV të Procedurave të Prokurimit, dhe me dispozitat e këtij kapitulli.

3. Përkufizime. Termat me germa kapitale të përdorura më poshtë në këtë kapitull për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metoda rishikimi nga Shoqata të kontratave të veçanta, i referohen metodës korresponduese përshkruar në Procedurat e Prokurimit ose Procedurat e Konsulentit, sipas rastit.

Metoda të posaçme për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve

Tenderi i Hapur Ndërkombëtar. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat dhe shërbimet do të prokurohen sipas kontratave të lidhura mbi bazën e Tenderit të Hapur Ndërkombëtar.

Metodat e tjera për prokurimin e Mallrave dhe Shërbimeve. Tabela më poshtë specifikon metodat e prokurimit, përveç atyre të Tenderit të Hapur Ndërkombëtar, të cilat mund të aplikohen për mallrat dhe

shërbimet. Plani i Prokurimit do të specifikojë rrethanat në të cilat këto metoda mund të përdoren:

Metoda e prokurimit
a) Tenderi i hapur kombëtar – me modifikimet e parashikuara në paragrafin 3 si më poshtë
- Blerje
-Tender Ndërkombëtar i kufizar
- Prokurim nga Agjencitë e Kombeve të Bashkuara

3. Tenderi i hapur kombëtar - Përmirësimi i procedurave të konkurrimit. Për të siguruar kosto-efekshmërinë, transparencën dhe përputhshmëri të gjerë me dispozitën e nënkapitullit I të Procedurave të Prokurimit, Procedurat e Përfituesit për konkurrimin në tender të hapur kombëtar do të përmirësohen si më poshtë;

i) Procedurat e “Tenderit të Hapur” ashtu siç parashikohen në ligj për prokurimet publike do të aplikohen për të gjitha kontratat;

ii) Konkurrentët e huaj nuk do të pengohen dhe nuk do t’u jepet asnjë preferencë konkurrentëve kombëtarë gjatë procesit të aplikimit. Ndërmarrjet me pronësi shtetërore në Shqipëri do të lejohen të konkurrojnë vetëm nëse janë ligjërish dhe financiarisht autonome sipas ligjit tregtar të Huamarrësit;

iii) Subjektet prokuruese do të përdorin dokumente standarde aplikimi të aprovuara nga Shoqata;

iv) në rastin e ofertimit të çmimeve më të larta sesa vlerësimi zyrtar, asnjë nga ofertat nuk do të rrëzohet pa marrëveshjen paraprake me Shoqatën;

v) në rastin e dorëzimit të ofertës do të përdoret procedura me një zarf të vetëm;

vi) post-kualifikimi do të kryhet vetëm për ofertuesit me ofertën më të ulët; asnjë ofertë nuk do të refuzohet në kohën e hapjes së tenderit për arsye që kanë të bëjnë me kualifikimin;

vii) ofertuesit që kontraktajnë si ndërmarrje e përbashkët do të konsiderohen bashkërisht dhe individualisht përgjegjës;

viii) kontratat do t’i fitojë ofertuesi me ofertën më të ulët, i cili pranon kualifikimin për të kryer shërbimin në përputhje me kriteret e paracaktuara dhe paradeklaruara të vlerësimit;

ix) negociatat post-ofertuese nuk do të lejohen me ofertuesit me ofertën më të ulët apo çdo ofertues tjetër; dhe

x) kontratat me një kohëzgjatje (më shumë se 18 muaj) do të përmbajnë dispozita të përshtatshme për rregullimin e çmimeve.

C. Metoda të veçanta për Prokurimin e Shërbimeve të Konsulentëve

1. Përzgjedhja mbi bazën e cilësisë dhe koston. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen sipas kontratave të fituara mbi bazën e cilësisë dhe koston.

2. Metoda të tjera për Prokurimin e Shërbimeve të Konsulentëve. Tabela më poshtë specifikon metodat e prokurimit, përveç përzgjedhjes së bazuar në cilësi dhe kosto, të cilat mund të përdoren për shërbimet e konsulentëve. Plani i prokurimit do të specifikojë rrethanat në të cilat mund të përdoren këto metoda.

Metoda e prokurimit
a) Konsulentë individualë
b) Përzgjedhje e bazuar në kualifikimin e konsulentëve
c) Përzgjedhje nga një burim i vetëm.
d) Përzgjedhje me buxhet të fiksuar

D. Rishikimi nga Banka i vendimeve të prokurimit

Plan i Prokurimit do të parashikojë ato kontrata të cilat do t’i nënshtrohen në rishikimi prioritar nga ana e Shoqatës. Të gjitha kontratat e tjera do të jenë subjekt i post rishikimit nga ana e Shoqatës.

NËNKAPITULLI V

Tërheqja e shumave të financimit

A. Të përgjithshme.

1. Përfituesi mund të tërheqë shumën e financimit në përputhje me dispozitat e këtij nënkapitulli dhe instruksioneve shtesë që mund të specifikojë Banka dhe me njoftim të Përfituesit, për financimin e Shpenzimeve të Ligjshme/lejuara siç përcaktohen në tabelën në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela poshtë specifikon kategoritë e Shpenzimeve të Ligjshme që mund të financohen përtej vlerës së financimit ("Kategoria"), alokimet e shumave të financimit për çdo kategori, dhe përqindjen e shpenzimeve për t'u financuar për Shpenzimet e Ligjshme/lejuara në secilën kategori:

Kategoria	Shuma e alokuar e financimit (e shprehur në SDR)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar
1) Mallra, punime, Kosto operionale dhe Fond Kompensimi.	[ekuivalent me \$4,417,100]	100%
2) Shërbime të konsulentëve dhe trajnime.	[ekuivalent me \$282,900]	100%
3) Mallra të importuara sipas planit të projektit siç specifikohen në nënkapitullin V.C të kapitullit 2	[ekuivalent me \$300,000]	100%
SHUMA TOTALE	[ekuivalent me \$5,000,000]	

B. Kushtet e tërheqjes; periudha/afati i tërheqjes.

1. Pavarësisht dispozitave të pjesës A në këtë nënkapitull, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për:

a) pagesat e bëra përpara datës së Marrëveshjes, përveç tërheqjeve në vlerën e një shume totale jo më të madhe se [\$300,000 ekuivalent] që mund të jenë bërë për pagesa të kryera përpara kësaj date, por jo që prej 1 majit 2006 dhe në vazhdim ; dhe

b) shpenzimet nën kategorinë (3) në tabelën e nënkapitullit V.A.2 të kapitullit 2 të kësaj Marrëveshjeje, nëse: (i) nuk është shpallur nga Përfituesi gjendja e emergjencës kombëtare për Influncën Aviare dhe nuk është miratuar një program i mirëkonceptuar emergjence për rikuperim, i pranuar edhe nga Shoqata; (ii) për mallrat e furnizuara sipas një kontrate që ndonjë institucion apo agjenci kombëtare ose ndërkombëtare përveç Shoqatës do të financojë ose ka rënë dakord për të financuar apo që Shoqata ka financuar ose ka rënë dakord të financojë në kuadrin e një Granti ose Kredie tjetër; dhe (iii) nëse kapërcehet shuma totale prej 50% e vlerës së financimit për çdo kategori të importeve të lejuara, specifikuar në kapitullin V.C të kapitullit 2 në këtë Marrëveshje pa miratimin paraprak të Shoqatës.

2. Data e mbylljes është 30 qershori 2009.

C. Listën e mallrave të importuara sipas planit të projektit për t'u financuar si emergjencë Kombëtare me kredi.

1. Produkte farmaceutike dhe vaksina;
2. Mallra dhe pajisje mjekësore dhe veterinare;
3. Veshje dhe pajisje mbrojtëse.

KAPITULLI 3

KALENDARI I RIPAGIMEVE

Data e pagesës	Shuma e principalit të kredise për t'u paguar (e shprehur në përqindje)*
Çdo 1 maj dhe 1 nëntor:	
Duke filluar që nga 1 nëntor 2016 deri dhe duke përfshirë 1 majin 2026.	5%

*Përqindjet përfaqësojnë përqindjen e shumës së principalit të kredisë për t'u paguar, përveç kur Shoqata mund të parashikojë ndryshe sipas paragrafit 3.03 (b) mbi kushtet e përgjithshme.

SHTOJCË

KAPITULLI I PËRKUFIZIME

1. “Programi vjetor i punës” nënkupton planin vjetor të aktiviteteve të mbështetur nga Projekti, për t'u zbatuar në çdo vit kalendarik, i përgatitur nga Përfituesi dhe rënë dakord ndërmjet Përfituesit dhe Shoqatës bazuar në nënkapitullin II.2 të kapitullit 2 në këtë Marrëveshje.

2. “Task Forcë për Influncen Aviare “TFIA” nënkupton organin vendimmarrës ndërmjësor apo ndërsektorial i kryesuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe përbërë nga përfaqësues të ministrive të ndryshme, i ngritur në tetor 2005.

3. “Kategori” nënkupton një kategori të parashikuar në tabelën në nënkapitullin V të kapitullit 2 në këtë Marrëveshje.

4. “Granti i bashkefinancuar” nënkupton shumën e tetëqind mijë (800 000) dollarëve për t'u kontraktuar ndërmjet Përfituesit dhe Shoqatës, e cila vepron si një administruese për Qeverinë japoneze, për të asistuar në financimin e Projektit.

5. “Marrëveshja për bashkefinancim granti” nënkupton marrëveshjen që do të lidhet ndërmjet Përfituesit dhe Shoqatës, si një administruese e fondeve të ofruara nga Qeveria Japoneze për bashkefinancimin e Grantit.

6. “Fond kompensimi” nënkupton fondin e ngritur nga Përfituesi jashtë shumës së kredisë, dhe për t'u financuar dhe vënë në efikasitet sipas parimeve dhe procedurave të parashikuara në POM, me destinacion kompensimin e pronarëve të shpendëve për shpendët e grumbulluara; dhe parashtruar në pjesën II.3(d) të kapitullit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

7. “Procedurat e Konsulentit” nënkupton “Rregullat: Përzgjedhjen dhe Punësimin e Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore” publikuar nga Banka në maj 2004.

8. “Plani i emergjencës për Influncën Aviare” nënkupton planin për trajtimin e influencës aviare të përgatitur nga Qeveria e Përfituesit me asistencën e Organizatës Botërore të Shëndetit dhe agjencitë e Kombeve të Bashkuara, që mban datën 6 mars 2006.

9. “Plani i Menaxhimit Mjedisor” nënkupton planin që përmban një seri masash zbatuese, monitoruese dhe institucionale për t'u ndërmarrë me synim eliminimin e impakteve negative mjedisore dhe sociale, balancimin e tyre dhe reduktimin në nivele të pranueshme, si dhe veprimet që nevojiten për të vënë në zbatim këto masa.

10. “Kushtet e përgjithshme” nënkupton “Kushtet e përgjithshme për Kredi dhe Grante të Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar”, të datës 1 korrik 2005.

11. “IAPL” nënkupton Influncën Aviare Patogjene të Lartë.

12. “Instituti Kërkimeve Veterinare” nënkupton Institutin e Kërkimeve Veterinare të Përfituesit ngritur në 1928 nga Qeveria e Shqipërisë dhe përfshin çdo pasardhës apo pasardhësa nën këtë emërtesë.

13. “ISHP” nënkupton Institutin e Shëndetit Publik të Përfituesit) i ngritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.19, datë 22 prill 1968.

14. “Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” ose “MBUMK” nënkupton Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të Përfituesit dhe përfshin çdo pasardhës apo pasardhësa nën këtë emërtesë.

15. “Ministria e Shëndetësisë” ose “MSH” do të thotë Ministria e Shëndetësisë e Përfituesit dhe përfshin çdo pasardhës apo pasardhësa nën këtë emërtesë.

16. “Laboratori i Influncës Aviare” nënkupton laboratorin e Përfituesit për influencën, i ngritur sipas [AUTORITETI me [DATË]].

17. “Kosto operationale” nënkupton shpenzimet marginale/perritese të kryera nga MBUMK, MSH dhe Sekretariati i TFIA për llogari të zbatimit të Projektit, përfshirë kostot e komunikimit, printimit dhe publikimet, pajisje, funksionimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, komisionet bankare, kostot e udhëtimeve lokale dhe të atyre të terrenit, qiratë e zyrës, dhe shërbimet, të gjitha bazuar në buxhetin

vjetor që do të përgatitet nga Sekretariati i TFIA dhe aprovohet nga Shoqata.

18. “Parimet e prokurimit” nënkupton “rregullat e prokurimit për Kreditë e IBRD dhe IDA” publikuar nga Banka në maj 2004.

19. “Plani i Prokurimeve” nënkupton planin e prokurimit të Përfituesit për Projektin që daton 28 prill 2006 dhe i trajtuar në paragrafin 1.16 të Parimeve të Prokurimit dhe paragrafin 1.24 të Procedurave të Konsulentit, i cili mund të përditësohet kohë pas kohe në përputhje me dispozitat e paragrafëve në fjalë.

20. “Koordinatorët e Projektit” nënkupton dy koordinatorët e projektit të zgjedhur në mënyrë konkurruese nga TFIA.

21. “Manuali i funksionimit të Projektit” nënkupton manualin që përshkruan: (i) procedurat për zbatimin e Projektit, koherente me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe me ligjet dhe rregulloret kombëtare të Përfituesit dhe që përfshin midis të tjerash: (ii) procedurat që rregullojnë menaxhimin administrativ, prokurimin, kontabilitetin dhe financën, përfshirë masat adekuate për prokurimin dhe auditet ligjore, dhe rregullimet në aspektin e monitorimit dhe vlerësimit; (iii) formatet tip për raportet vjetore; (iii) Programet e planifikuara vjetore të punës për tre vite kalendarike; dhe (vi) parimet dhe procedurat për financimin dhe vënien në efikasitet të Fondit të Kompensimit të trajtuara në pjesën II.3(d) të kapitullit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

22. “Trajnime” do të thotë shpenzimet e kryera për llogari të Projektit dhe që lidhen me vizitat studimore, kurset e trajnimit, seminarët, workshopet dhe aktivitete të tjera trajnuese, përfshirë udhëtimet dhe dietat e të trajnuarve dhe trajnerëve.